



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:120936

Datë: 24.10.2024

Numri i dokumentit: 06442042

KA.nr.579/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarja Vlora Pacolli Rexhepi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Raf II” SH.P.K., me pronar Xh.H. Toni, me seli në Rahovec me NRB 70177148, përfaqësua sipas autorizimit nga Z.F., nga Zyra për shërbime juridike “Fetoshi Law”, SH.P.K., me adresë në rrugën “Bedri Berisha”,Nr. 342, me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP), me seli në Prishtinë, me adresë Rruga “Migjeni”, ish ndërtesa e Bankës Lubjanës, Kati i V-të, për shkak të anulimit të Vendimit PSH.nr. 561/2020 të datës 18.09.2020 i të paditurës OSHP, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik më datë 01.10.2024 dhe më datë 15.10.2024 me pjesëmarrje të autorizuar të përfaqësuesit të paditësit ndërsa në mungesë të përfaqësuesit të palës së paditur, më datë 24.10.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **APROVOHET** e bazuar kërkesëpadia e paditësi “Raf II ” SH.P.K me seli në Rahovec, NRB 70177148, kundër të paditurit Organi Shqyrtues i Prokurimit me seli në Prishtinë.
- II. Anulohet Vendimit PSH.nr. 561/2020 të datës 18.09.2020 dhe lënda të kthehet të paditurës në rishqyrtim dhe rivlerësim.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Historiku procedural

1. Më datë 25.09.2020, në Gjykatën Themelore të Prishtinës, Departamenti për Çështje Administrative paditësi “Raf II ” SH.P.K., Xh.H. Toni, me seli në Rahovec përmes përfaqësuesit të tij me autorizim ka parashtruar padi (e evidentuar me nr.A.1582/2020), kundër të paditurit Organi Shqyrtues i Prokurimit (tutje referuar OSHP), me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të vendimit PSH.nr. 561/2020 të datës 18.09.2020 me propozim që të aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpapia e paditësit, të anulohet si i pa bazuar vendimi i të paditurës Nr. 561/20 i datës 18.09.2020 dhe lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivlerësim.
2. Pas funksionalizimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës sipas Ligjit Nr. 08L-015 për Gjykatën Komerciale, lënda është bartur në këtë Gjykatë dhe evidentohet me shifrën KA.nr. 579/22.
3. Gjykata caktoj dhe mbajti seancë të shqyrtimit kryesor më datë 01.10.2024 pastaj më datë 15.10.2024 me pjesëmarrje të përfaqësuesit të palës paditëse Z.F. sipas autorizimit të datës 30.09.2024, ndërsa konform nenit 41 të LKA-së në mungesë të përfaqësuesit të palës së paditur i ftuar në mënyrë të rregullt, ftesën për seancë e ka pranuar me datë 04.10.2024, ftesës nuk i është përgjigjur dhe mungesën nuk e ka të arsyetuar.

#### Pretendimet e paditësit

4. Përfaqësuesi i paditësit në pretendimet e dhëna në padi, pretendimet gjatë seancës së shqyrtimit kryesor si dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se ne aktivitetit të prokurimit me titull “Ndërtimi i Objektivit Spitalor për nënën dhe fëmijën në Prizren”, me numër të prokurimit 00220-19-5304-5-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës (tutje referuar si AK-SHSHKUK), e paditura OSHP fillimisht përmes tre vendimeve paraprake PSH.nr. 772/19, është anuluar vendimin për dhënie të kontratës ku paditësi është rekomanduar për kontratë, OE “Hidroterm ka parashtruar ankesë, me vendimin PSH.nr. 39/20, ka anuluar vendimin e AK për dhënie të kontratës. Me datë 08.04.2020 paditësi është njoftuar se është eliminuar si tenderues. Paditësi ka parashtruar ankesë. Me vendimin PSH.nr. 253/20 dt. 15.06.2020 e ka aprovuar pjesërisht të bazuar ankesën e paditësit sa i përket tenderit të lartshënuar dhe e ka kthyer lëndën në rivlerësim të AK-SHSHKUK, ndërsa paditësi më datë 30.07.2020 ka pranuar një e-mail nga AK-SHSHKUK ku është njoftuar mbi njoftimin e vendimit të AK-së se është shpallur si tenderues i

pasuksesshëm. Padiësi ka parashtruar më datë 03.08.2020 kërkesën për rishqyrtim, ndërsa ankesë në OSHP më datë 12.08.2020, sepse me këtë vlerësim AK nuk e ka respektuar fare vendimin paraprak të OSHP-së nr. 25.20 të datës 15.06.2020 me të cilin vendim është vërtetuar se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës NPN “Hidroterm” është i papërgjegjshëm, ngase nuk i plotëson të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë. E paditura me vendimin e kundërshtuar Nr. 561/20 ka aprovuar pjesërisht ankesën e padiësit ndërsa ka lënë në fuqi vendimin e AK për dhënie të kontratës.

5. Ka shtuar se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës është i pa përgjegjshëm për faktin se AK në nenin 8.1&8.2 të FDT-së ka përcaktuar kërkesën si në vijim: Kërkesa 1 Operatori Ekonomik (tutje referuar OE) duhet të ofroj dëshmi se qarkullimi vjetor i tij gjatë tre viteve të fundit nga data e njoftimit për kontratë ka qenë gjithsej jo më pak se 8,000,000.00 euro. Lideri i grupit duhet të përmbushë së paku 60% të qarkullimit minimal dhe deklarata tatimore vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës për tre vitet e fundit. Sipas tij, duke u bazuar në këtë dokumentacion të OE të rekomanduar për kontratë, vërehet se ky OE nuk ka ofruar Deklarata Tatimore Vjetore të dorëzuara në ATK për tri vitet e fundit jo më pak se 8,000,000.00 euro, për më tepër OE i rekomanduar për dhënie të kontratës ka ofruar edhe raporte të auditimit, vërtetime nga banka dhe dëshmi të ATK-së që nuk korrespondojnë njëra me tjetrën, duke mos e përmbushur këtë kërkesë dhe është dashur të eliminohet siç është eliminuar tri herë të tjera me të drejtë nga ana e AK-së. Ka shtuar se eksperti i OSHP-së në ekspertizën e datës 07.05.2020, me nr. 253/20 OE të rekomanduar për kontratë NPN “Hidroterm” ia ka pranuar vlerat e qarkullimit në Mal të Zi se kinse janë të degës së OE të rekomanduar për kontratë. Te analizat financiare që ka bërë eksperti i OSHP-së rezultojnë mospërputhje të vlerave ndërmjet qarkullimit financiar në banka me qarkullimin përmes ATK-së, ndërsa qarkullimit na Mal të Zi eksperti i OSHP-së i referohet dëshmimeve të raportit të qarkullimit financiar nga institucioni kompetent, mirëpo nuk ka sqaruar se cili është ai institucion kompetent.
6. Ka theksuar se gjatë qasjes në dokumente të OE të rekomanduar për kontratë, nuk kanë hasur që NPN “Hidroterm” është në konzorcium me ndonjë kompani tjetër, ndërsa qarkullimi i llogaritur të “Hidroterm Doo” dega Mal i Zi i llogaritur nga eksperti, kjo operator është entitet tjetër juridik, ka regjistrim në një shtet tjetër, me numër tjetër të biznesit, dhe për tu pranuar ndonjë qarkullim nga ai, është dashur të ekzistoj marrëveshja e konzorciumit.

7. Ka theksuar se kërkesa e AK-së ka qenë së dëshmitë nga OE-të duhet të sjellën vetëm nga Administrata Tatimore e Kosovës, ndërsa OE i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk e plotëson kërkesën e FDT-së në lidhje me qarkullimin financiar, sipas të dhënave që ka prezantuar OE i rekomanduar nga ATK-ja rezulton se: për vitin 2016 ka deklaruar në ATK vlerën prej 1,635,010.31 euro, për vitin 2017 ka deklaruar në ATK vlerën prej 2,242.286.58 euro, për vitin 2018 ka deklaruar në ATK, 2,228.931.78 euro, në total 6,106.228.67 euro, ndërsa në FDT është kërkuar vlera prej 8,000.000.00 euro, dhe se sipas FDT-së për vitin 2016 nuk duhet të merret parasysh komplet gjashtë mujori i parë i këtij viti. AK-ja është dashur të vlerësoj në bazë të kërkesave të tij të vendosura në FDT dhe te njoftimi për kontratë pasi që është kërkuar qarkullimi për tri vitet e fundit nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, që është data 30.07.2019 prandaj qarkullimi bankar duhet të merret nga data 30.07.2016 deri 30.07.2019, ndërsa duke e pasur parasysh këtë periudhë OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson kërkesën e lartpërmendur. Sipas tij, për dallim nga ATK-ja qarkullimi bankar i OE të rekomanduar për kontratë në bankat e Kosovës për vitet 2016, 2017, 2018 rezulton të jetë 7,011.989.84 euro duke shkaktuar mospërputhje në mes të vlerave të qarkullimit bankar me qarkullimin në ATK që shpie në dyshime për mosparaqitje të gjendjes reale në ATK nga OE i rekomanduar për kontratë.
8. Ka deklaruar se OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka plotësuar edhe Kërkesën nr.2 të nenit 8.1 &8.2 të FDT-së ku është kërkuar që “ OE duhet të ketë të paktën 300.000.00 euro, asete likuide, financiare p.sh në llogarinë bankare ose të paktën 300,000.00 euro qasje për kredi në dispozicion, ndërsa te Dëshmi Dokumentare është kërkuar Dëshmia nr.2 deklarata nga banka që e vërteton disponueshmërinë e 300,000.00 euro në llogarinë bankare të kompanisë apo një vërtetim bankar në origjinal që e konfirmon që kompania mund të merr kredi në vlerë prej 300,000.00 euro, ndërsa data e deklaratës nuk duhet të jetë më e hershme se nga data e publikimit të njoftimit për dhënie të kontratës, ndërsa OE i rekomanduar për kontratë si dëshmi ka bashkangjitur nja certifikatë nga “Raiffeisen Bank” ku shkruan se e konfirmojnë se NPN Hidroterm është një nga klientët e tyre dhe se do e marrin seriozisht mundësinë e mbështetjes me kredi në vlerë prej 300.000.00 euro pasi që të jenë përmbushur kriteret interne për kredi, pra OE i rekomanduar nuk e plotëson këtë kërkesëpadi që kjo certifikatë nuk është premtim ashtu siç është kërkuar.
9. Sipas tij, OE i rekomanduar për kontratë është i pa përgjegjshëm për faktin se nuk ka ofruar kontrata valide të kryera brenda tri viteve të kaluara në vlerën e kërkuar pasi që, duke u

bazuar në dëshmitë nga qasja në dokumente AK-ja nuk ka kërkuar sqarime shtesë sipas nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së nga OE “NPN Hidroterm” se i njëjti a i plotëson kërkesat në lidhje me kapacitetin teknik dhe profesional në periudhën e kaluar tre vjeçare, pasi që sa i përket Kontratës me Komunën e Nikshiqit ku si anëtari konsorciumit ka qenë “Hidroterm” D.O.O, nuk mund të merret parasysh kjo kontratë sepse NPN “Hidroterm” nuk është anëtar i konsorciumit për një entitet tjetër, dhe ndërtimi i impiantit nuk duhet të llogaritet si ndërtim i lartë, po ashtu as kontrata e nënshkruar me zyrën e BE-së nga Gintas& Hidroterm në vlerë prej 10,031.937,39 euro e lidhur më datë 05.09.2012 nuk është kontratë me ndërtim të lartë, dhe nuk dihet se sa punë janë kryer nga anëtari i konsorciumit NPN “Hidroterm” dhe në çfarë vlere janë kryer punët në periudhën e kërkuar tri vjeçare. Gjithashtu se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës është i pa përgjegjshëm nga fakti se i njëjti ka borxhe ndaj ATK-së fakt i vërtetuar nga vërtetimi i ATK-së të datës 08.04.2020 ku shkruan se NPN “Hidroterm” ka marrëveshje për shlyerjen e borxheve mirëpo legjislacioni i prokurimit nuk e lejon që të shpallet i përgjegjshëm një OE i tillë, pra në kundërshtim me nenin 65 par. 4.8 i LPP-së që parasheh se OE-të nuk duhet të kenë borxhe ndaj ATK-së për të marr pjesë në një aktivitet të prokurimit.

10. Përfundimisht ka deklaruar se vendimi i të paditurës me nr. 561/2020 i datës 18.09.2020, është jo profesional, subjektiv, kundërthënës ku OSHP i referohet interpretimit të KRPP-së të datës 22.07.2020 nuk mund të jetë opinion i vlefshëm, sepse nuk dihet nga kush është i lëshuar sepse nuk përmban as emër e as mbiemër por figuron në emër të adresës Rregullat e KRPP-së prandaj nuk mund të lëshohen opinione në këtë mënyrë, gjithashtu të njëjtat nuk janë obligative ashtu siç parashihet me nenin 87 par. 2.3 të LPP-së. Vendimi i kundërshtuar me padi si i njëanshëm nuk janë të shqyrtuar pretendimet ankimore të paditësit, dhe sa i përket pretendimit të palës së paditur se subjekti juridik NPN “Hidroterm” është pronar i kompanisë “Hidroterm” doo ., në Mal të Zi dhe se duhet të merren parasysh qarkullimet financiare edhe të kësaj kompanie, në asnjë dispozitë ligjore nuk është i mbështetur ky konstatim pasi që është bërë në mënyrë të njëanshme dhe me qëllim të favorizimit të OE të rekomanduar për dhënie të kontratës. Gjykatës i ka propozuar që të aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadi e paditësit, të anulohet si i pa bazuar vendimi i të paditurës Nr. 561/20 i datës 18.09.2020 dhe lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivlerësim.

#### Kundërshtimet e të paditurës

11. Përfaqësuesi i të paditurës në përgjigje në padi të dorëzuar përmes parashtresës së datës 03.07.2024 ka deklaruar se lidhur me pretendimin ankimore të OE ankues kundrejt ofertës së OE të rekomanduar për dhënie të kontratës se i njëjti nuk e plotëson vlerën e kërkuar të deklarimeve të kryera të qarkullimit në ATK për vitet e kërkuara, dhe se i njëjti nuk ka ofruar kontrata valide të kryera brenda tri viteve të kaluara në vlerën e kërkuar, sa përket këtyre dy pikave ankimore më herët është nxjerr një vendim duke mos i pranuar dëshmitë nga filiali i OE të rekomanduar në shtetin e Malit të Zi me arsyetim se i njëjti nuk ka hyrë në konzorcium, mirëpo duke pasur parasysh se në platformën e e-prokurimit është ngarkuar interpretimi i KRPP-së i datës 26.06.2020 sipas kërkesës së OE të rekomanduar për kontratë, ku në këtë interpretim të KRPP-së thuhet se: sa i përket pyetjeve të parashtruara opinioni i KRPP-së është si në vijim: Në rast se një Kompani filiale (degë), që kryejnë të njëjtën veprimtari në disa vende (shtete) tjera kompania në fjalë mund ti shfrytëzoj të gjitha kapacitetet e degëve të saj për ti përmbushur kërkesat e parashtruara të Dosjes së Tenderit dhe në njoftimin për kontratë dhe për këtë qellim nuk duhet të tenderoj si grup i OE-ve ekonomik sepse në fakt konsiderohet si një operator ekonomik.
12. Ka theksuar se, në rastin konkret qarkullimi dhe kontratat e kryera nga filiali apo dega e OE “Hidroterm” doo dega Mal të Zi duhet të pranohen pasi që OE i rekomanduar për duhet të konsiderohet si kompani ame. Në vendimin paraprak Paneli Shqyrtues i SHP-së nuk ka qenë në dijeni për këtë interpretim, ku sipas praktikave të mëparshme në rastet kur kanë aplikuar dy kompani që kanë pasur pronar të njëjtte Paneli Shqyrtues i ka trajtuar si dy subjekte të ndryshme juridike, ndërsa në rastin konkret vet subjekti juridik është pronar. Paneli Shqyrtues ka marr parasysh nenin 104 par. 4 pika iii. të LPP-së, dhe duke e pasur parasysh se çmimi i OE të rekomanduar për kontratë është 4,915.029.40 euro, ndërsa i OE ankues është 5,044,388.89 euro bie që i njëjti ka ofertuar me çmim më të lartë prej 129,395.49 euro. Gjykatës i ka propozuar që të refuzohet si e pa bazua kërkesëpadia e paditësit ndërsa vendimi me nr. PSH.nr. 561/2020 i datës 17.09.2020 i OSHP-së të vërtetohet si i ligjshëm.

#### Provat e administruara

13. Gjykata me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit kontestues dhe vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në seancën e shqyrtimit kryesor ka administruar

këto prova: Njoftimi për kontratë nga AK SHSKUK me nr. të prokurimit 00220-19-5304-5-1-1 me titull ndërtimi i objektit spitalor për nënën dhe fëmijën në Prizren me datë 30.07.2019, Njoftim mbi vendimin e AK me datë 18.10.2019 me të cilin anulohet aktiviteti i prokurimit me arsyetim se të gjithë operatorët ofertues janë vlerësuar si të pa përgjegjshëm, Kërkesë për rishqyrtim nga OE “Raf II” SH.P.K me datë 24.10.2019, Vendim nga AK me të cilin refuzohet kërkesa për rishqyrtim me datë 28.10.2019, Ankesë me datë 01.11.2019 në OSHP nga OE “Raf II” SH.P.K kundër vendimit të AK, Raport i Ekspertit shqyrtues të prokurimit me datë 18.11.2019, Vendim i Panelit Shqyrtues të OSHP-së me nr. 772/2019, Letër standarde për ofertuesin e suksesshëm grupi i OE “Raf II” SH.P.K dhe “KAG Asphalt Company” SH.P.K, Njoftim mbi vendimin e AK-së me datë 24.12.2019 , Raport i ekspertit shqyrtues me datë 31.01.2020 në ankesën e OE “Hidroterm” SH.P.K, Vendim i panelit shqyrtues të OSHP-së me numër PSH.39/20 me datë 12.02.2020, Njoftim mbi vendimin e AK-së me datë 08.04.2020, Kërkesë për rishqyrtim me datë 13.04.2020 nga OE Raf II SH.P.K për AK SHSKUK, Vendim me datë 15.04.2020 i AK-së për refuzim të kërkesë për rishqyrtim, Ankesë me datë 17.04.2020 e paditësit “Raf II” SH.P.K drejtuar OSHP-së kundër vendimit të AK-së, Raport i ekspertit shqyrtues me datë 07.05.2020 në ankesën e OE Raf II SH.P.K, Vendim i panelit shqyrtues me nr. 253/20 me datë 12.06.2020 me të cilin lënda kthehet në rivlerësim, Njoftim mbi vendimin e AK me datë 30.07.2020, Kërkesë për rishqyrtim nga OE “Raf II” SH.P.K me datë 03.08.2020 drejtuar OSHP-së kundër vendimit të AK-së, Vendim i AK-së me datë 07.08.2020 për refuzim të kërkesë për rishqyrtim , Ankesë e OE “Raff II” SH.P.K me datë 12.08.2020 drejtuar OSHP-së kundër vendimit të AK-së, Raporti i ekspertit shqyrtues me datë 01.09.2020 në shqyrtim të ankesës së OE “Raf II” SH.P.K, Vendim i panelit shqyrtues me nr. PSH.561/20 me datë 17.09.2020, Dosja e tenderit të OE të rekomanduar për kontratë Hidroterm SH.P.K me të cilat ka ofertuar në aktivitetin e prokurimit, të dorëzuara nga përfaqësuesi i paditësit në këtë seancë.

14. Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe në përputhje me nenin 8 të LPK-së vlerësoj provat e administruara në seancën e shqyrtimit kryesor në raport me pretendimet e paditësit në padi, përgjigjen e të paditurës në padi, deklaratimet e tyre në seancë si dhe pas shqyrtimit gjeti se kërkesëpadija e paditësit është pjesërisht e bazuar.

15. AK-SHSHKUK më datë 30.07.2019 ka publikuar njoftimi për kontratë nga me nr. të prokurimit 00220-19-5304-5-1-1 me titull “Ndërtimi i objektit spitalor për nënën dhe fëmijën në Prizren”, kriter i dhënies së kontratës çmimi më i ulët. Tek kushtet e pjesëmarrjes kërkesa e përshtatshmërisë 1. III.2.3) te kapaciteti ekonomik financiar te kërkesa 1. OE duhet të ofroj dëshmi se qarkullimi vjetor i tij, gjatë tre viteve të fundit nga data e njoftimit për kontratë ka qenë gjithsej jo më pak se 8,000,000.00 euro, Lider i grupit duhet të përmbush së paku 60 % qarkullimit minimal. Tek dëshmia e kërkuar dokumentare është kërkuar qarkullimi bankar për tri vitet e fundit nga data e njoftimit për kontratë jo më pak se 8,000,000.00 euro (origjinal të vërtetuar nga banka). Dëshmia 1.1. Deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës për tri vitet e fundit të përfunduara fiskale nga data e njoftimit për kontratë jo më pak se 8,000,000.00 euro. Të kërkesa 2. OE duhet të ketë të paktën 300.000.00 euro asete likuide financiare p.sh në llogarinë bankare ose të paktën 300,000.00 euro qasje për kredi në dispozicion, ndërsa te dëshmia 2. Deklarata nga banka që e vërteton disponueshmërinë e 300,000.00 euro në llogarinë bankare të kompanisë apo një vërtetim bankar në origjinal që konfirmon se kompania mund të merr kredi prej 300.000.00 euro nëse është e nevojshme. Data e deklaratës bankare nuk mund të jetë më herët se data e publikimit të njoftimit për kontratë. Kërkesat e përshtatshmërisë III.2.4) te kërkesa 1. sa i përket kapacitetit ekonomik dhe profesional OE duhet të dëshmoj se ka referenca të këtij lloji të punimeve (ndërtimit të lartë) minimum tri referenca, ndërsa te dëshmia e kërkuar dokumentare Dëshmia 1, është kërkuar të dëshmohet punët e kryera në ndërtime të larta në periudhën e shkuar tri vjeçare, duke tregua vlerën, datë, natyrën dhe vendodhjen e projekteve duke i bashkangjitur referenca dhe ose procesverbalet e pranimit përfundimtar të punëve, ndërsa te kërkesa 2. Kërkohe të dhëna për projekte të implementuara, titulli i projektit si dhe vlera totale e projektit të realizuara gjatë tri viteve të fundit në vlerë jo më pak se 8,000,000.00 euro, ndërsa te Dëshmia 2. është kërkuar të dëshmohet me kontrata dhe pranime teknike së paku një referencë me vlerë min 1,5 mil. Në fushën e ndërtimitarisë së lartë gjatë tre viteve të fundit të implementuara me sukses nga OE.
16. Dosja e tenderit të OE të rekomanduar për kontratë Hidroterm SH.P.K me të cilat ka ofertuar në aktivitetin e prokurimit, ATK përmes vërtetimit tatimor të datës 05.08.2019 ka njoftuar se Hidroterm SH.P.K. është i regjistruar në ATK dhe aktualisht është në marrëveshje me këste për të shlyer borxhet tatimore të mbetura është bashkangjitur qarkullimi i deklaruar për vitet 2016, në shumë totale prej 2,157,359.31 euro, për vitin



2017, përfshin vlerën në total prej 3,633,047.62 euro dhe për vitin 2018, qarkullimi i deklaruar përfshin vlerën në total prej 2,228,931.78 euro. Te qarkullimi bankar për vitin 2016 përfshin shumën totale prej 1,719.487.30 euro, për vitin 2017 përfshin vlerën në total prej 5,754,984.13 euro dhe për vitin 2018, qarkullimi bankar përfshin vlerën në total prej 1,745,703.75 euro, total 9,220,15.18 euro.

17. Nga njoftim mbi vendimin e AK-së me datë 18.10.2019 është anuluar aktiviteti i prokurimit me arsyetim se të gjithë operatorët ofertues janë vlerësuar si të pa përgjegjshëm. OE “Raf II” SH.P.K me datë 24.10.2019 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim drejtuar AK SHSKUK-së sa i përket tenderit “Ndërtimi i objektit spitalor për nënën dhe fëmijën në Prizren”, me nr. Të prokurimit 00220-19-5304-5-1-1. AK SHSKUK përmes vendimit të datës 28.10.2019 e ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të OE “Raf II” SH.P.K tani paditës.
18. Paditësi ka parashtruar ankesë me datë 01.11.2019 në OSHP, kundër vendimit të AK SHSKUK-së, sa i përket tenderit “Ndërtimi i objektit spitalor për nënën dhe fëmijën në Prizren”, me nr. të prokurimit 00220-19-5304-5-1-1. Paneli Shqyrtues i OSHP-së përmes vendimit me nr.PSH.nr.772/2019 të datës 09.12.2019, në pikën I e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar ankesën e OE ankues “Raf II” SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “ Ndërtimi i objektit spitalor për nënën dhe fëmijën në Prizren” me nr. të prok 00220-19-5304-5-1-1 të iniciuar nga AK, SHSKUK, ndërsa në pikën II e ka anuluar njoftimin për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i objektit spitalor për nënën dhe fëmijën në Prizren” me nr. të prok. 00220-19-5304-5-1-1 të iniciuar nga AK SHSKUK dhe lëndën e ka kthyer në rivlerësim.
19. Përmes letër standarde për ofertuesin e suksesshëm AK SHSKUK ka njoftuar grupin e OE “Raf II” SH.P.K dhe “KAG Asphalt Company” SH.P.K, se kanë dorëzuar tenderin me çmimin më të ulët. AK-SHSHKUK me datë 24.12.2019 përmes njoftim mbi vendimin ka shpërblyer me kontratë OE “Raf II” SH.P.K., KAG Asphalt Company SH.P.K., në vlerë prej 5.044.388,89 euro.
20. Paneli Shqyrtues i OSHP-së me vendimin me numër PSH.39/20 me datë 12.02.2020 në pikën I e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar ankesën e OE ankues N.P.N “Hidroterm” SH.P.K., SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “ Ndërtimi i objektit

spitalor për nënën dhe fëmijën në Prizren” me nr. të prok. 00220-19-5304-5-1-1 të iniciuar nga AK, SHSKUK në pikën II e ka anuluar njoftimin për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i objektit spitalor për nënën dhe fëmijën në Prizren” me nr. të prok. 00220-19-5304-5-1-1 të iniciuar nga AK SHSKUK dhe lëndën e ka kthyer në rivlerësim.

21. Në rivlerësim AK SHSKUK përmes njoftim mbi vendimin më datë 08.04.2020, ka shpërblyer me kontratë NPN “Hidroterm” SH.P.K në vlerë prej 4.915.029,40 euro. OE tani paditës “Raf II” SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim me datë 13.04.2020 drejtuar AK SHSKUK lidhur me tenderin ‘Ndërtimi i objektit spitalor për nënën dhe fëmijën në Prizren’, për aktivitetin e prokurimit 00220-19-5304-5-1-1. AK SHSKUK përmes vendimit të datës 15.04.2020 ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim parashtruar nga OE tani paditës “Raf II” SH.P.K.
22. Paditësi “Raf II” SH.P.K ka parashtruar ankesë me datë 17.04.2020 drejtuar OSHP-së kundër vendimit të AK-së sa i përket tenderit ‘Ndërtimi i objektit spitalor për nënën dhe fëmijën në Prizren’, për aktivitetin e prokurimit 00220-19-5304-5-1-1.
23. Paneli Shqyrtues i OSHP-së përmes vendimit me nr. 253/20 me datës 12.06.2020 në pikën I të vendimit e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar ankesën e OE ankues “Raf II” SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “ Ndërtimi i objektit spitalor për nënën dhe fëmijën në Prizren” me nr. të prok . 00220-19-5304-5-1-1 të iniciuar nga AK, SHSKUK, në pikën II e ka anuluar njoftimin për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i objektit spitalor për nënën dhe fëmijën në Prizren” me nr. të prok. 00220-19-5304-5-1-1 të iniciuar nga AK SHSKUK dhe lëndën e ka kthyer në rivlerësim me arsyetim se pretendimi i OE ankues është se “Hidroterm”, Doo, Dega Mali i Zi duhet të trajtohet si një entitet tjetër juridik nga NPN Hidroterm Kosovë, si pasojë dëshmitë e ATK-së nuk përputhen me dëshmitë e qarkullimeve financiare bankare të OE të rekomanduar për kontratë. Lidhur me pretendimin tjetër se OE i rekomanduar për kontratë është i pa përgjegjshëm nga fakti se i njëjti ka borxhe në ATK, paneli shqyrtues ka sqaruar se nuk ka ndonjë dëshmi për dënimin e OE të rekomanduar për kontratë, ndërsa sa i përket borxheve ekziston interpretimi i KRPP-së me nr. 64 ku ndër të tjera shkruan që “ Nisur nga fakti që shumë OE kanë marrëveshje për shlyerje të borxheve me ATK-në KRPP-ja sqaron se në këtë rast marrëveshjet për shlyerjen e

borxheve duhet të jenë para datës së publikimit të njoftimit për kontratë”, ndërsa sipas panelit shqyrtues nuk ka pasur dëshmi konkrete se kur është bërë marrëveshja për shlyerjen e borxheve, të cilën fakt është dashur ta vërtetoj AK-ja.

24. Ne ri-vlerësim përmes njoftim mbi vendimin të datës 30.07.2020, AK SHSKUK ka shpërblyer me kontratë NPN “Hidroterm” SH.P.K. në vlerë prej 4.915.029,40 euro. OE “Raf II” SH.P.K me datë 03.08.2020 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim drejtuar OSHP-së kundër vendimit të AK SHSKUK, lidhur me tenderin “Ndërtimi i objektit spitalor për nënën dhe fëmijën në Prizren”, për aktivitetin e prokurimit 00220-19-5304-5-1. AK përmes vendimit të datës 07.08.2020 ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim, të OE “Raf II” SH.P.K sa i përket tenderit ‘Ndërtimi i objektit spitalor për nënën dhe fëmijën në Prizren’, për aktivitetin e prokurimit 00220-19-5304-5-1-1. OE “Raff II” SH.P.K me datë 12.08.2020 ka parashtruar ankesë drejtuar OSHP-së kundër vendimit të AK SHSKUK, sa i përket tenderit ‘Ndërtimi i objektit spitalor për nënën dhe fëmijën në Prizren’, për aktivitetin e prokurimit 00220-19-5304-5-1-1.
25. Paneli Shqyrtues i OSHP-së përmes vendimit me nr. 561/20 të datës 17.09.2020 në pikën I të vendimit e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar ankesën e OE ankues “Raf II” SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “ Ndërtimi i objektit spitalor për nënën dhe fëmijën në Prizren” me nr. të prok. 00220-19-5304-5-1-1 të iniciuar nga AK, SHSKUK në pikën II e ka vërtetuar njoftimin për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i objektit spitalor për nënën dhe fëmijën në Prizren” me nr. të prok. 00220-19-5304-5-1-1 të iniciuar nga AK SHSKUK.
26. Paneli shqyrtues ka vlerësuar se duke pasur parasysh se në platformën e e-prokurimit është ngarkuar interpretimi i KRPP-së i datës 26.06.2020 sipas kërkesës së OE të rekomanduar për kontratë, ku në këtë interpretim të KRPP-së thuhet se: sa i përket pyetjeve të parashtruara opinioni i KRPP-së është si në vijim: Në rast së një Kompani filiale (degë), që kryejnë të njëjtën veprimtari në disa vende (shtete) tjera kompania në fjalë mund ti shfrytëzoj të gjitha kapacitetet e degëve të saj për ti përmbushur kërkesat e parashtruara të Dosjes së Tenderit dhe në njoftimin për kontratë dhe për këtë qëllim nuk duhet të tenderoj si grup i OE-ve ekonomik sepse konsiderohet si një operator ekonomik, në këtë rast “ kompania amë” kompania në vendin ku gjendet selia e saj dhe “kompania motra”, kompanitë e vendeve të ndryshme operojnë si degë të kompanisë amë. Në rastin

konkret qarkullimi dhe kontratat e kryera nga filiali apo dega e OE “Hidroterm” doo-Mal të Zi duhet të pranohen pasi që OE i rekomanduar për duhet të konsiderohet si kompani amë. Paneli Shqyrtues i OSHP-së ka sqaruar se në vendimin paraprak nuk ka qenë në dijeni për këtë interpretim, ku sipas praktikave të mëparshme në rastet kur kanë aplikuar dy kompani që kanë pasur pronar të njëjte Paneli Shqyrtues i ka trajtuar si dy subjekte të ndryshme juridike, ndërsa në rastin konkret vet subjekti juridik është pronar. Duke e pasur parasysh se çmimi i OE të rekomanduar për kontratë është 4,915.029.40 euro, ndërsa i OE ankues është 5,044,388.89 euro bie që i njëjti ka ofertuar me çmim më të lartë prej 129,395.49 euro.

### Vlerësimi i gjykatës

27. Gjykata e vlerëson pjesërisht të bazuar pretendimin e paditësit lidhur me subjekti juridik të NPN “Hidroterm” dhe “Hidroterm” doo, sepse paneli shqyrtues i ka pranuar qarkullimi dhe kontratat e kryera nga filiali apo dega e OE “Hidroterm” doo dega Mal të Zi me arsyetim *se OE i rekomanduar duhet të konsiderohet si kompani amë, me arsyetim se vet subjekti juridik “Hidroterm” shpk është pronar andaj ka vlerësuar se OE “Hidroterm” shpk me seli në Suharekë dhe “Hidroterm” doo me seli në Mal të Zi, nuk duhet të tenderoj si grup i OE-ve ekonomik sepse konsiderohet si një operator ekonomik, në këtë rast “kompania amë” kompania në vendin ku gjendet selia e saj dhe “kompania motra”, kompanitë e vendeve të ndryshme operojnë si degë të kompanisë amë. Në rastin konkret qarkullimi dhe kontratat e kryera nga filiali apo dega e OE “Hidroterm” doo-Mal të Zi duhet të pranohen pasi që OE i rekomanduar për duhet të konsiderohet si kompani amë. Këtë arsyetim të Panelit Shqyrtues gjykata e vlerëson si të pabazuar në ndonjë provë, sepse nuk është e qarte se në cilat dëshmi është bazuar Paneli Shqyrtues për të ardhur në konstatim se “Hidroterm” doo me seli Mal të Zi është themeluar si degë e kompanisë amë OE “Hidroterm” shpk me seli në Suharekë, sepse në shkresa të lëndës nuk ka asnjë certifikate të regjistrimit për të konstatuar këtë pretendim. Nga provat materiale për Hidroterm – BK DOO, dëshmitë e dorëzuara në gjykatë që kanë të bëjnë me dëshmitë bankarë të lëshuara nga NLB banka Mal të zi për Hidroterm – BK DOO, nuk ka të dhëna se e njëjta është dege e kompanisë amë siç thuhet në arsyetim të Paneli Shqyrtues i OSHP-së.*

28. Konform nenit 36 të Ligji Nr. 06/L -016 për Shoqëritë Tregtare për regjistrimin e degës në një vend tjetër kërkohet certifikata e regjistrimit në vendin e origjinës, në këtë rast “Hidroterm” shpk me seli në Suharekë certifikata nga ARBK dhe Vendimi i kompanisë amë për Krijimin e Degës së Shoqërisë së Huaj Tregtare. Prandaj në shkresat e lendes nuk ka asnjë vendim të “Hidroterm” shpk me seli në Suharekë për themelimin të degës në Mal të Zi, për tu konsideruar se dega nuk është person juridik i ndarë ose i veçantë nga Shoqëria e që e ka themeluar atë. Pra në rastin në fjalë, e paditura nuk ka dorëzuar asnjë dëshmi Certifikatë dhe të dhënat e biznesit për Hidroterm – BK DOO me seli në Mal të Zi, Vendim të kompanisë “Hidroterm” shpk me seli në Suharekë të cilën e konsideron si kompani amë për Krijimin e Degës së Shoqërisë së Huaj Tregtare në Mal të Zi.
29. Gjykata e vlerëson si jo kontestues interpretimin e KRPP-së të datës 26.06.2020 se në rast *së një Kompani filiale (degë), që kryejnë të njëjtën veprimtari në disa vende (shtete) tjera kompania në fjalë mund të shfrytëzoj të gjitha kapacitetet e degëve të saj për të përmbushur kërkesat e parashtruara të Dosjes së Tenderit dhe në njoftimin për kontratë dhe për këtë qëllim nuk duhet të tenderoj si grup i OE-ve ekonomik sepse konsiderohet si një operator ekonomik, në këtë rast “ kompania amë” kompania në vendin ku gjendet selia e saj dhe “kompania motra”, kompanitë e vendeve të ndryshme operojnë si degë të kompanisë amë*, mirëpo vlerëson se ky sqarim është relevant vetëm nëse paraprakisht vërtetohet subjektiviteti juridik i Kompanisë Hidroterm – BK DOO me seli në Mal të Zi se e njëjta është e themeluar si degë e “Hidroterm” shpk me seli në Suharekë.
30. Gjykata sqaron se pa u vërtetuar subjektiviteti juridik i OE “Hidroterm” D.O.O, me seli në Mal të Zi në raport me “NPN Hidroterm” me seli në Suhareklë, nuk mund të vlerësohet se OE i rekomanduar për kontratë a i plotëson kërkesat në lidhje me kapacitetin teknik dhe profesional sipas kërkesave të përshtatshmërisë të kapaciteti ekonomik financiar Njoftimit për kontratë.
31. Prandaj gjykata konstaton se vendim i kundërshtuar 561/20 i datës 18.09.2020 është në kundërshtim me Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (LPP), Neni 7 përcakton Barazinë në Trajtim/ Jo-Diskriminimi paragrafi 1 parasheh se “Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente”, paragrafi 2 parasheh se

“Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shume operatoreve ekonomik”.

32. Prandaj, obligohet e paditura, në përputhje me nenin 65 të Ligjit për Konflike Administrative, që në afat prej tridhjetë (30) ditësh, në ri procedurë të veprj sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim dhe t'i mënjanoj të metat lidhur me vendimin kontestues ashtu që së pari ta sqaroj subjektiviteti juridik i OE “Hidroterm” D.O.O, me seli në Mal të Zi në raport me “NPN Hidroterm” me seli në Suhareklë, dhe nga gjendje e vërtetuar faktike e ta bazuar në prova të vlerësohet se OE i rekomanduar për kontratë a i plotëson kërkesat në lidhje me kapacitetin teknik dhe profesional sipas kërkesave të përshtatshmërisë të kapaciteti ekonomik financiar Njoftimit për kontratë.
33. Sa i përket pretendimit i paditësit se OE rekomanduar për dhënie të kontratës është i pa përgjegjshëm nga fakti se i njëjti ka borxhe ndaj ATK-së fakt i vërtetuar nga vërtetimi i ATK-së të datës 08.04.2020 ku shkruan se NPN “Hidroterm” ka marrëveshje për shlyerjen e borxheve, në kundërshtim me nenin 65 par. 4.8 i LPP-së që parasheh se OE-të nuk duhet të kenë borxhe ndaj ATK-së për të marr pjesë në një aktivitet të prokurimit, gjykata vlerëson se vendimi është bazuar në interpretimi i KRPP - së i publikuar në E-Prokurimi (rks-gov.net) 64. 17.04.2019. A duhet OE me rastin e dorëzimit të ofertës të dëshmojnë se nuk janë në vonesë në pagimin e tatimeve ndaj ATK-së? Paragrafi 4.8 i nenit 65 të LPP-së percaktohet se “aktualisht është me vonesë në pagimin e çfarëdo kontributeve për sigurim social apo tatim në Kosovë ose në vendin e themelimit të operatorit ekonomik, përveç ku një borxh i tillë është vërtetuar të jetë jo i rëndësishëm në Kosovë” KRPP pranon edhe marrëveshjet për shlyerje të borxheve por *sqaron se edhe në këtë rast marrëveshjet për shlyerje të borxheve duhet të jete para datës së publikimit të njoftimit të kontratës*, dhe përderisa vendimi është i publikuar në webportalin e KRPP-së konsiderohet se është lëshuar nga autoriteti kompetent pretendimet e paditësi se nuk dihet se kush e ka lëshuar këtë interpretim janë të pabazuara.
34. Pretendimi i paditësit se OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka plotësuar edhe Kërkesën nr.2 të nenit 8.1 &8.2 të FDT-së ku është kërkuar që “ OE duhet të ketë të paktën 300.000.00 euro, asete likuide, financiare p.sh në llogarinë bankare ose të paktën 300,000.00 euro qasje për kredi në dispozicion, është i pabazuar sepse certifikata nga

“Raiffeisen Bank” te cilet e konfirmojnë se NPN Hidroterm është një nga klientët e tyre dhe se do e marrin seriozisht mundësinë e mbështetjes me kredi në vlerë prej 300.000.00 euro pasi që të jenë përmbushur kriteret interne për kredi, në original që e konfirmon që kompania mund të merr kredi në vlerë prej 300,000.00 euro, është dëshmi se OE i rekomanduar për kontratë ka bashkangjitur dëshmi për qasje në kredi në dispozicion.

35. Andaj, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 paragrafi 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Lidhur shpenzimet procedurale si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata vendosi në bazë të nenit 64 të LKA-së.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.579/22, datë 24.10.2024.

Gjyqtarja

Vlora Pacolli Rexhepi

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.